

PROCESVERBAL

Nga Komiteti i IX (Nëntë) të rregullt të Komitetit për komunitete , mbajtur më datën : 24.09.2024.
me këtë:

Rendi i ditës

- 1) Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
- 2) Shqyrtimi i materialit të kuvendit për seancën e IX (Nëntë),
- 3) Eventuale.

Miralem Rahte : Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë mysafirë të pranishëm, po hapi takimin e pestë të Komitetit për Komunitete për këtë vit, para fillimit të këtij takimi dua të konstatoj nëse kemi kuorum. Meqenëse kemi, më lejoni të bëj një pyetje, a e keni marrë materialin të gjithë anëtarët e Komisionit për Komunitete në kohën e përcaktuar me ligj, të përkthyer në gjuhët tuaja amtare? A ka dikush ndonjë fjalë për rendin e ditës? Po e hedhi në votim miratimin e axhendës së sotme të propozuar. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Meqenëse rendi i ditës është miratuar, kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

Pika I - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mëparshme

Z. Miralem Rahte – A ka dikush për të diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës dhe procesverbalit. Meqenëse nuk ka, e hudhi në votim miratimin e kësaj pike të rendit të ditës. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

Pika II - Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e 9-të,

Z. Miralem Rahte – Pika e dytë të ditë rendit të ditës : *Shqyrtimi i materialit kuvendit për seancën e IX*. Materiali përmban këto pika :- Propozim vendim për miratimin e buxhetit të komunës së Dragashit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027,. A ka dikush diçka për të thënë për këtë pikë të rendit të ditës? Meqenëse nuk ka, e hudhi në votim miratimin e kësaj pike të rendit të ditës. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

- Pika e tretë: 3. Propozim vendim për shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale,

Pika e tretë e rendit të ditës

Miralem Rahte: A ka dikush diçka për të thënë për këtë pikë të rendit të ditës. A kemi ndonjë kërkesë drejtuar Komitetit? Meqenëse jo, a dëshiron dikush i pranishëm të marrë fjalën dhe të hapë një diskutim. Meqë nuk ka, me këtë mbyll seancën e sotme të Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete

Miralem Rahte